




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.50/2024
Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe Rregullores Nr.02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimimin nga Detyra të Gjyqtarëve Porotë, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Deli Duraj, gjyqtar porot në Gjykatën Themelore në Ferizaj, për transferim në Gjykatën Themelore në Ferizaj – Dega Kaçanik.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar nga Deli Duraj, gjyqtar porot në Gjykatën Themelore në Ferizaj, kërkesën për transferim në Gjykatën Themelore në Ferizaj – Dega Kaçanik. I njëjti kërkesën e tij e ka arsyetuar me faktin e vendbanimi i tij aktual është në Komunën e Kaçanikut.

Pas vlerësimit të kërkesës së z. Duraj, KGJK-ja vendosi ta refuzoj të njëjtën sepse me asnjë dispozitë të legjislacionit në fuqi, nuk parashihet transferimi i gjyqtarëve porotë si dhe po ashtu mënyra e caktimit të tyre bëhet sipas renditjes së përcaktuar me vendim të Këshillit dhe e njëjta vlen për secilën gjykatë, gjithashtu përkundër që konkursi ka qenë i hapur edhe për Gjykatën Themelore në Ferizaj – Dega Kaçanik, i njëjti nuk ka aplikuar.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Vendimi i dërgohet:

- Gjyqtarit porot Deli Duraj;
- Sekretariatit të KGJK-së,
- Arkivit të SKGJK-së.